



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 8-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31.05.2022, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
9. Sami Bytyqi, anëtar
10. Fitim Shala, anëtar
11. Xhyzide Rustemi, anëtare
12. Rinor Murati, anëtar
13. Armend Grajqevci, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Gentianë Hoxhaj, anëtare
16. Venhar Agushi, anëtar
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Anila Reçica, DKRS
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Shkelzen Hajdini, DSH
8. Flamur Sylejamni, DI
9. Elmaze Behluli, DA
10. Sead Aliu, DI
11. Rexhep Rexhepi, DBP
12. Rasim Hasani, DA
13. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 7-të e Kuvendit-së.
2. Propozim Vendim për miratimin e Planit vjetor të punës së KKS-së për vitin 2022.
3. Propozimi Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKS-së.
4. Propozim Vendim për fillimin e procedurave për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë - faza e parë.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në Qylagë - faza e parë.
6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të subjekteve afariste në zonën ekonomike “Parku Industrial” në Qylagë.
7. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
8. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.

Pastaj Kryesuesi tha se me propozim te kryetarit kemi edhe një pikë shitesë nga drejtorati i shëndetësisë, ku si pikë e ka marrë edhe rekomandimin e KPF-së, e për të cilën pikë e keni marrë edhe materialin me kohë nga sektori i kuvendit

9. Propozim vendim për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit mbi përfshirjen sociale në komunën e Lipjanit 2022-2024

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës të propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Arsim Jashari tha,se kam për t'i ngritur disa shqetësime, e para ka të bëjë me mbjelljen e fidanëve nëpër fshatra ku në fshatin Banullë afër 50 fidane janë tharë. Kush është menaxher i këtij projekti, a i mbikëqyr dikush a po ujitet ose jo? Çështja e dytë ka të bëjë me punësimet familjare, a doni me i ndal ,apo doni me vazhdua me punësime familjare? E treta, do të flas për demokracinë, LDK-ja e ka promovuar demokracinë, së bashku me kryetarin Imri Ahmeti, por komuna nuk po bënë këtë pasi që transmetimi online i mbledhjeve të kuvendit nuk po bëhet, e qytetarët nuk po e shohin punën që po bëhet në mbledhjet e kuvendit. E deri më sot kjo nuk po ndodh pse nuk po ndodh e dini ju! Ne si këshilltar të PDK-së kemi qenë konstruktiv duke dhënë propozime, rekomandime e disa herë edhe janë aprovuar. Në faqen e komunës nuk keni asnjë propozim as foto të opozitës. Puna e kuvendit duhet të respektohen nga të gjithë dhe për të gjithë.

Rinor Murati, tha se do të ngris një çështje të rëndësisë së veçantë e ajo është sporti, ku tash ne si Lipjan jemi pa përfaqësuese në Super Ligën e Kosovës në Futboll. KF Ulpiana dhe KF "Arbëria" po kanë një fazë jo të lehtë e cila mund të kthehet në dëshpërim te grupmoshat e reja. Po ashtu gjendje të njëjtë kemi edhe në basketboll, ndërsa në volejbol jemi pak më mirë. Por falë punës së mirë kemi një infrastrukturë të mirë për sportin. Ne në planin e punës në komitetin për Kulturë Rini dhe Sport temë do ta kemi çështjen e sportit ku në mbledhjen e ardhshme do të diskutojmë dhe do të dalim me rekomandimet tona. Çështja e dytë ka të bëjë me hedhjen e mbeturinave të këpurdhave në rrugën Lipjan-Rubovc,ku këtë shqetësim e kam adresuar edhe në drejtoratin për Inspektion. Çështja e fundit, hudhja e kafshëve të ngordhura me peshë të rënda në rrugë Rubovc –Lipajn.

Besaina Sylja tha se,dua t'i ngris dy çështje që kanë të bëjnë me hallin e qytetarëve, e para ka të bëjë me rregullimin e shtratit të lumit në fshatin Qellopek pasi që këta banorë ankohen për vërshime të lumit, sa herë që ka reshje te shiut.

Ngase uji po ju hyn në shtëpi sa herë që ka reshje. A ka buxhet për këta ose jo, dhe duhet këtyre banorëve të ju bëhet një zgjidhje. Çështja e dytë ka të bëjë me rrugën “Mbretu Zog”, ku kanë ngecur punimet a pritet të vazhdojnë punimet në atë rrugë.

Egzona Bytyqi, tha së pari ju uroj suksese maturantëve në testin e maturës. Po ashtu kam pyetje për DKA-në, se sa janë të përfshirë nxënësit në orientimin dhe këshillimin në karrierë. Pasi që kjo temë është trajtuar shumë nga organizata të ndryshme jo qeveritare. Nga DKA-ja, a ju është nda hapësire këtij diskutimi me kolegji me në të cilat takoheni nga të gjitha komunat.

Shahadije Dragaçina, tha se unë do ta ngrisë një çështje që ka të bëjë me banorët e Janjevës. Afër 40, punëtorë, të cilët punojnë në Prishtinë, por transporti iu është ndërprerë nga kompania dhe ata banorë kanë mbete në pozitë shumë të vështirë. Këta kërkojnë nëse ka mundësi komuna të ju bëjë ndonjë zgjidhje. Ndërsa çështja tjetër ka të bëjë me publikimin e raportit të auditorit, ku auditori ka nxjerr raportin e fundit ku edhe këtë vit ky institucion ka gjetë parregullsi, shkelje, e keq menaxhime në komunë të cilat janë bërë gjatë vitit të kaluar. Ku nga 12 gjetje të gjetura 3 janë përsëritura nga vitet e kaluara 2020, ndërsa 9 rekomandime janë të reja. Me këtë del që komuna ka zgjedhur operatorët e pa përgjegjshëm që nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara. Po ashtu ka gjetur se ka pas mangësi mbi pagesën e subvencioneve për klubet sportive, si dhe disa shkelja tjera.

Daut Azemi, tha raporti i auditorit do ta kemi në seancën e ardhshme, dhe këtu kemi të bëjmë me pyetje të anëtarëve të kuvendit e jo me diskutime.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës tha, çështja e fidanëve është e drejtë, por është kontratë e pa përfunduar por është ende në proces. Sa i përket çështjes së punësimit e kam respektua ligjin dhe askujt nuk ja kam prurë në punë, gruan, apo burrin, djalin apo vajzën të zyrtarëve, bile kemi pas kujdes as praktikantë nuk kemi marrë të tyre, derisa praktikantët e ma hershme kanë qenë krejt ndryshe. Transmetimi online, seancat transmetohen audio pas mbylljes, ndërsa live jo se kemi problem me rjetin, por pritet me dale në objektin e komunës se re shumë shpejtë dhe aty besoj që do të dalim live. Sa i përket publikimit të fotove në faqe të komunës nuk i qet asnjë komunë ato të opozitës, por vetëm i promovon vendimet e mira të komunës. Askush nga ana juaj nuk e uroj komunën për fitimin e çmimit të dytë si komuna më e mirë, për këtë duhet të ndiheni krenar ju dhe të gjithë qytetarët e komunës tonë. Raporti i auditorit do të dalë shumë shpejtë në kuvend dhe jemi duke përgatit planin e miratimit të rekomandimeve dhe jam shumë i kënaqur që Lipjani është në mesin e 5 komunave që e ka raportin e pamodifikuar. Por duhet me ditë çka po lexoni. Sa i

përket sportit këtë vit janë ndarë 10 mijë euro vetëm për sportin nëpërmes konkursit publik për të gjitha klubet e sportit. Unë jam i kënaqur me rezultatet që ata kanë, Këtu klube duhet me i shndërruar në shoqëri aksionare. Sa i përket Lumit të fshatit Qellopek, po pres mos po e rregullojnë disa ministra e zëvendësministra që vinin për fushatë e vizitonin këtë vend mos po e rregullojnë. Na jemi duke punuar në atë fshat për rregullimin trotuarit dhe ndriçimit publik, e do të rregullojmë edhe lumin. Ndërsa sa i përket autobusit Prishtinë- Janjevë ai ka qenë kompani private, dhe kjo është çështje e konkurrencës private dhe ne si komunë nuk mund të ndërhyjmë. Pasi që ato nuk janë kompani që menaxhohen nga komuna. Mbeturinate këpurdhave ia ka dhënë punëtorit të për shpërndarje në arat e tij.

Ardit Cani, tha se kam për t'i ngritur disa çështje; e para ka të bëjë me Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm, ku para disa seancave kemi miratuar rregulloren për monumentet kulturore dhe kërkoj që të zbatohen kjo rregullore, dhe të mirëmbahet vendi të rregullimi i ujit të nxehtë në fshatin Bainsë, nëse ka mundësi të angazhohet një kompani nga komuna pasi që aty ka vizitorë të shumtë, Kërkesa e dytë ka të bëjë me rregullimin e rrugës bujqësore në të cilën furnizohen bujqit për punimin e tokës bujqësore.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ka një kërkesë për rrugën "Ibrahim Gashi" në Akllap, e cila ka mbet në gjysmë, kur pritët të vazhdojë?

Nexhmedin Lekiqi, tha se kam një kërkesë që në ato drejtorate që nuk kanë telefona fiks, të ju sigurohen telefonat fiks si dhe një sekretaresh ku do të ingjizoheshin pyetjet e qytetarëve, lidhur me kërkesat e tyre dhe ato që janë më të arsyeshme të i'u jepen përgjigjet. Pasi që numri për qytetarët duhet me qenë fiks, për çdo kërkesë të tyre. E dyta, në Gadime janë bërë shumë gjëra të mëdha, por rruga kryesore për në Gadime, nuk është punuar boll, pasi që aty ka vizitorë të shumë dhe ka nevojë për investime.

Lulzim Rustemi, tha kam me i ngrite disa shqetësime; a ka në të gjitha shkollat ujë të pijshëm, është mirë përmes organizatës Katar që të pajisen të gjitha shkollat me ujë të pijshëm dhe të ju largohen nxënësve shishet e ujit. E dyta, ka të bëjë me ujërat e zeza që kalojnë për rreth lumit "Sitnica", deri në cilin nivel ka arrit pasi që ka qenë një projekt i madh për në impiant të madhë se bashkë me Prishtinën Fushë Kosovën dhe Lipjani. Pasi që do të bëhej një punë e madhe.

Bashkim Budakova, tha se kam një kërkesë të banorëve të qytetit të Lipjanit për shenjëzimin e rrugëve pasi që po paraqet rrezik të madh edhe për këmbësorët edhe për vozitësit e veturave, e sidomos në rrugën “ Haredin Bajrami”.

Alban Salihu, tha se e kam një pyetje për drejtorin e bujqësisë pasi ka ankesa për vonesa, të përfituesve të vendosjes së serave.

Arsim Jashari, tha se procesi i seancave online, është obligim ligjor, dhe ato po shkëputen nuk po dalin të gjitha komplet. Ndërsa sa i përket grandit të fituar nga komuna ne jemi falënderueses, por edhe ne kemi kontribut për këtë grand. Do të ishte mirë që propozimet e mira qoftë të pozitës apo të opozitës të publikohen në faqen e komunës.

Rasim Hasani, tha se sa i përket orientimit në karrierë, në disa shkolla në bashkëpunim me KEC-in kemi filluar. Sa i përket ujit të pijshëm në të gjitha shkollat kemi ujë të pijshëm. Por nuk kemi ujësjellës në të gjitha shkollat dhe nuk guxojmë të ju themi ne nxënësve mos merrni ujë me vete.

Rexhep Rexhepi, tha se kemi pas pak ndërprerje për shkak të operatorit i cili nuk ka mundësi me siguruar hekurin për sera, por na jemi në afat sa i përket kontratës dhe shumë shpejtë pritet të fillojë puna aty ku ka mbet.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, investimet që kërkohen është e drejte dhe ne vitet e ardhme pritet të futen në buxhet. Sa i përket rrugës hyrëse deri në gatime ajo është rrugë regjionale, dhe po presim të marrim pëlqim për atë rrugë për ta kryer vet. Sa i përket ujërave të zeza kjo ka stagnua, janë ne proces të bisedimeve me fondet e jashtme, presim me ditët në vijim mos po bëjmë ndonjë zgjidhje. Pengesat në rrugë është çështje e inspekcionit. Po presim me përfunduar rruga 4 kursi, tani do të fillojmë procesin e shenjëzimit në të gjitha rrugët e qytetit.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e VII-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin? Pastaj Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e VII e Kuvendit pas votimit konstatoi se Kuvendi me, me 30 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja VII-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II.

Propozim Vendim për miratimin e Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Diamant Bytyqi nënkryetar i komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Rinor Murati, tha se është për t'u vlerësuar një plan i tillë, por te aktiviteti nr rendor 19, kërkoj që t'i kushtohet me shumë rëndësi dukurisë së bullizmit në shkolla.

Arsim Jashari, tha se është një plan shumë i qëlluar, ju kisha rekomanduar që të jetë një plan për vedijësimin e qytetarëve për mos ndezjen e zjarreve gjatë korrije-shirjeve.

Diamant Bytyqi, aktivitetet e planit të KKSB-së janë koordinuar edhe me strategjitë kombëtare për temë të ndryshme qoftë bullizmi, dhuna në shkolla dhe dukuri të tjera. Zjarrfikësit janë në mungesë të stafit, po kemi kërkuar që të paktën kontratë mbi vepër apo vullnetare të angazhohen për punën gjatë verës.

Arsim Jashari, është mirë me marrë si model komunën e Ferizajt ku e ka një plan të tillë si të menaxhohet situata gjatë kohës së verës.

Lulzim Rrustemi, tha se është një plan i mirë por është mirë që anëtarët e KKSB-së, me pas bashkëpunim me pakicat e në veçanti në nivelin e bashkëpunimit të shkollave, ku shkollat e serbëve ta ngrisin nivelin e bashkëpunimit komunal, si nivelin e programeve strukturimin, dhe të ketë bashkëpunim sa më të madh.

Diamt Bytyqi, tha se prifti i kishës ortodokse , ngrit shqetësim e komunitet në KKSB-, por ne do ta ngrisim edhe çështjen e arsimit.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi e vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi vendimin.

III

**Propozimi Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri
në Bashkësi – KKSB-së.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Diamant Bytyqit, nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj kryesuesi, hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi e vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi vendimin.

IV

**Propozim Vendim për fillimin e procedurave për shpalljen e konkursit
publik për vendosje të bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial”
në ZK Qylagë - faza e parë.**

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Daut Azemi, tha se në KPF-janë dhënë disa rekomandime, që çmimi të jetë 2 euro, dhe te pika 4 pas investimeve prodhuese do të shtohet pjesa sipas nenit 12 të ligjit për zonat ekonomike.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se na si fshat jo që e kemi pru aq mirë këtë, unë e kam shfletuar ligjin, e kam një dozë të shqetësimit sa i përket asaj pjesë sa i përket shëndetit publik. Por a ka ndonjë mekanizëm nga komuna për mbikëqyrje të kësaj zone. Shpresojmë që të jetë një zonë që ka me tërheqë investitor.

Lulzim Rrustemi, tha se është bërë një punë e mirë, tani është koha që investitorët me ja mësyer Lipjanit. Pse jemi fokusuar vetëm në 6.8 hektarë. Shpresojmë që të ketë interesim të investitorëve.

Valon Pacolli, na si komunë e kemi të drejtën ta caktojmë një komision apo një menaxher që ta monitoroj atë zonë. Deri tani i kemi vetëm 6.8 hektarë të gatshëm për investim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha, meqë diskutime tjera nuk pati e vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi vendimin.

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në Qylagë - faza e parë.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se ne si grup i LDK-së, për anëtar të komisionit propozojmë Fitim Shalën.

Arsim Jashari, tha se ne si grup i PDK-së për anëtar të komisionit e propozojmë Lulzim Rustemin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për 6 abstenime, aprovoi vendimin

VI

Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të subjekteve afariste në zonën ekonomike “Parku Industrial” në Qylagë.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DBEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për 6 abstenime, aprovoi Vendim për formimin e Komisionit të aksionarëve.

VII

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se ne si grup i LDK-së për anëtare të komisionit e propozojmë Majlinda Sylejmanin.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se ne si grup i PDK-së për anëtar te komisionit e propozojmë Arsim Jasharin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për dhe 6 abstenime, aprovoi Vendim

VIII

Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se ne si grup i LDK-së, për anëtar te komisionit e propozojmë Sami Bytyqin.

Egzona Bytyqi, tha se ne si grup i PDK-së e propozojmë për anëtar te komisionit Lulzim Rrustemin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për dhe 4 abstenime, aprovoi Vendim

IX

Propozim vendim për miratimin e strategjisë dhe planit te veprimit mbi përfshirjen sociale ne komunën e Lipjanit 2022-2024

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit, drejtor i DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Nexhemdin Lekiqi, tha se na në Komitetin për Shëndetësi e kemi diskutuar dhe kemi dhënë edhe rekomandimet tona,sa i përket Planit dhe Strategjisë, ku është një plan shumë i mirë. Është një pikënisje e madhe për qytetarët e komunës së Lipjanit sa i përket këtij plani dhe presin përkrahjen tuaj.

Arsim Jashari,një plan shumë i mirë, e përgëzoj drejtoratin për punën, po ashtu edhe Komitetin, për Shëndetësi. dhe shpresojmë që do të realizohet në praktikë. Ne e mbështesin këtë plan si grup i PDK-së.

Lulzim Rrustemi, një plan i mirë,është mirë që do të ketë bashkëpunim me institucionet tjera,dhe presim që të ketë një statistike kredibile, pasi që kemi shumë kategori që kanë nevojë për ndihmë për mbështetje. Shpresoj që kjo do të realizohet dhe objektivat e saj do të arrihen.

Fitim Mëziu, tha na si grup i LVV-së e përkrahim këtë plan, por kemi një propozim që te objektiva numër 4 që të futet te ekipet mobile edhe Qendra për Punë Sociale,për arsye se ne kemi qasje direkte me qytetarët dhe mund të ndihmojmë më tepër sa i përket këtij plani dhe ne i dije më shumë nevojat e tyre.

Shkelzen Hjadini, tha se ju falënderoj për bashkëpunimin të secilit prej juve, po ashtu për propozimet dhe rekomandimet që i keni dhënë. Pajtohen që të futet edhe rekomandimi i parafolësit dr, Fitimit në këtë plan. Dhe shpresojmë qe kjo të realizohet në praktike.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për aprovoi Vendim

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 12,30

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi